




REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA E KOSOVOS	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. <u>DPK</u>	Br. Prot. <u>03-02/274</u>
Dep. _____	Prot. No. _____
Nr. l. faq. _____	Data _____
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>08-02-2017</u>
Nr. pages _____	Date _____
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.02.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4653/16, për z. Ilir Rexhepi, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" Sh.A, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ilir Rexhepi, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" Sh.A, dhe njëkohësisht Drejtor Menaxhues në Kosovo Management Institut dhe menaxher (person i autorizuar) në biznesin privat N.Sh "Leadership and Development Consultancy", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë në Agjencinë kundër Korrupsionit. Gjatë këtij takimi z. Rexhepi është njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Prandaj, Agjencia kundër Korrupsionit i ka kërkuar zyrtarit të lartë të heq dorë nga ushtrimi i funksioneve menaxheriale të lartë cekura sipas Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë, është deklaruar se do të ndërmarrë veprimet e nevojshme brenda afatit ligjor për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresat zyrtare (DPKI.03-02/151/17) (DPKI.03-02/186/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në Kosovo Management Institut dhe në biznesin privat N.Sh “Leadership and Development Consultancy“.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

